



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 11 tetor Trupi Gjykses miratoi redaktimet e propozuara për transkriptet e dëshmimeve të katër dëshmitarëve të mbrojtur, çka do të mundësojë që versionet e reja publike të transkripteve të jenë të disponueshme me më pak redaktime. Kjo u bë për të garantuar që procesi të jetë sa më shumë publik, në kuadër të përpjekjeve në vijimësi për të bërë publike sa më shumë materiale, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave.

Më 11 tetor, Administratorja njoftoi Trupin Gjykses për përfundimin e emërimit të z. Pitër Mekloski (Peter McCloskey) si bashkëmbrojtës i Hashim Thaçit, pas kërkesës së kryembrojtësit të z. Thaçi për përfundimin e kontratës së z. Mekloski si mbrojtës dhe emërimin e tij si konsulent. Mbrojtësi njoftoi Zyrën e Mbrojtjes se ky ndryshim nuk do të ndikonte negativisht në interesat e z. Thaçi ose në kohëzgjatjen e procesit.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 11 tetor, Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes për apelim të një vendimi të mëparshëm për pranim si prova të tri deklaratave të një dëshmitari që dha dëshmi më 28 dhe 29 gusht 2024. Në vendim, gjykatësit shpjeguan se konstatuan se deklaratat ishin *prima facie* relevante, autentike, provuese dhe jo dëmtuese për palët. Trupi Gjykses theksoi gjithashtu se, faktorë si pasaktësitë e pretenduara në deklaratat, gjykatësit do t'i marrin parasysh siç duhet gjatë vlerësimit të peshës që do t'u jepet deklaratave në kuadër të tërësisë së provave.

Po atë ditë, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Prokurorisë që një dëshmitar të japë dëshmi nëpërmjet videokonferencës, duke theksuar se Mbrojtja nuk pati asnjë kundërshtim, dhe konstatoi se gjendja shëndetësore e dëshmitarit arsyetohet dhënien e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës. Trupi Gjykses gjykoji gjithashtu se dhënia e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës mund të ndihmojë kryerjen e shpejtë të procesit.

Më 14 tetor, Trupi Gjykses hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes për apelim të një vendimi për pranimin si prova të një dokumenti, ku shpjegoi arsyet pse e kishte pranuar atë.

Po të njëjtën ditë, në vendime më vete, Trupi Gjykses zgjati paraburgimin e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Për të dy të akuzuarit, Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku se do të pengojnë procesin dhe/ose të kryejnë krime të tjera kundër dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore.





Në vendimin lidhur me paraburgimin e z. Thaçi, Trupi Gjykues kujtoi konstatimin e mëparshëm se duket se z. Thaçi u dha vizitorëve informacion të nxjerrë gjatë dëshmisë së një dëshmitari të mbrojtur dhe se dokumentet sugjerojnë se ai i dha një vizitori jo të privilegjuar udhëzime për t'ia kaluar një dëshmitari të ardhshëm të ZPS-së, lidhur me formën dhe përmbajtjen e dëshmisë që pritej të jepej nga ai dëshmitar.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 15 tetor, Trupi Gjykues mori vendim mbi një kërkesë të Prokurorisë në lidhje me pesë dëshmi të dëshmitarëve dhe prova materiale shoqëruese. Prokuroria propozoi që dëshmitë e tre dëshmitarëve të pranohen me shkrim dhe që ata të paraqiten në gjykim për t'u marrë në pyetje nga pala jothirrëse, sipas rregullës 154. Mbrojtja nuk kundërshtoi pranimin e tyre si prova sipas kësaj rregulle, por kundërshtoi disa prova materiale të propozuara. Në vendimin e tij, Trupi Gjykues i pranoi si prova disa nga këto materiale dhe hodhi poshtë të tjerat, duke dhënë arsyetimin për secilën prej tyre.

Në lidhje me dy dëshmitarë të tjerë, Prokuroria kërkoi që dëshmia e tyre të parashtrohet vetëm me shkrim sipas rregullës 153, ndërsa Mbrojtja argumentoi se këta dëshmitarë duhet të paraqiten në sallë të gjyqit për t'u marrë në pyetje. Për njërin prej dëshmitarëve, gjykatësit konstatuan se dëshmia e tij mund të pranohet sipas rregullës 153, sepse është përgjithësisht përsëritëse dhe konfirmohet nga dëshmitarë të tjerë të cilët Mbrojtja pati mundësi t'i merrte në pyetje, dhe për arsye se nuk lidhet drejtpërdrejt me veprimet dhe sjelljet e pretenduara të të akuzuarve.

Në lidhje me dëshmitarin tjetër, Trupi Gjykues hodhi poshtë kërkesën e Prokurorisë për të pranuar si prova deklaratat e tij, duke konstatuar se Mbrojtja duhet të ketë mundësinë për të verifikuar besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në dëshminë e tij, dhe mosdhënia e kësaj mundësie mund ta dëmtojë Mbrojtjen.

Seanca vijuese në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të hënë, 21 tetor, në orën 13:00. Seanca janë caktuar gjithashtu për të martën, mërkurën dhe të enjten e ardhshme, kur ato do të fillojnë në orën 09:00.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, versioni i redaktuar publik i njoftimit të rishikuar për apel të Mbrojtjes tani është në dispozicion në faqen e internetit të DHS-së, ku janë paraqitur arsyet për apel. Versioni i parë i njoftimit për apel u dorëzua konfidencialisht më 2 shtator.

Të premten, më 11 tetor, për arsye humanitare bindëse, Trupi Gjykues në çështjen gjyqësore Januzi dhe të tjerët udhëzoi Zyrën Administrative të organizonte një vizitë nën ruajtje të z. Haxhi Shala në Kosovë, për t'u takuar me anëtarët e familjes së ngushtë. Sikurse u raportua javën e kaluar, Zyra Administrative organizoi gjithashtu një vizitë nën ruajtje të Jakup Krasniqit në Kosovë për t'u takuar me anëtarë të familjes së ngushtë, në zbatim të udhëzimit të Trupit Gjykues bazuar në arsye humanitare bindëse. Gjatë të dyja vizitave nën ruajtje, të akuzuarit u mbajtën në paraburgim dhe nën ruajtje nga Dhomat e Specializuara. EULEX-i dhe policia e Kosovës mbështetën Dhomat e Specializuara të Kosovës.





Në çështjen gjyqësore *Januzi dhe të tjerët*, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë dje kërkesën e Haxhi Shalës për rishikim të vendimit për mbrojtje të ligjshmërisë që lidhej me paraburgimin e tij. Në shtator, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se nuk kishte pasur shkelje thelbësore të procedurave nga ana e Gjykatës të Procedurës Paraprake, i cili fillimisht urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit, ose nga Paneli i Apelit, i cili e konfirmoi vendimin.

